



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) neni 36 paragrafi 1 dhe neni 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, KSHPK duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri,

VENDIM

Denoncim për korrupsion me nr. 12-1756 / 1 të datës 04.05.2021, dërguar përmes platformës në internet për raportimin e korrupsionit, nga parashtrues i njohur-----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka juridiksion - nuk ka pohime ose indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare në lëndën me Nr. 12-1756/1 të datës 04.05.2021.

Lënda me numër 12 -1756 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

Arsyetim

Lënda me numrin 12-1756 nga 2021 u formua në bazë të denoncimit me nr. 12- 1756/1, datë 04.05.2021, nga parashtrues i njohur-----, i cili u dorëzua në mënyrë elektronike përmes ueb-faqes të KSHPK-së.

Në denoncim janë theksuar vërejtje në lidhje me -----, se, siç thuhet në denoncim, "keqpërdori fonde shtetërore gjatë orarit të punës për aktivitetet e partisë", pa deklaruar indikacione ose dëshmi specifike.

Bazuar në të gjitha rrethanat dhe të dhënat e përfshira në denoncimin e lëndës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, nga aspekti i kompetencave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në denoncimin e lëndës përcaktoi se nuk ka elemente të veprimit kompetent.

Për arsye, siç u tha më lart, Komisioni Shtetëror vlerësoi se denoncimi nuk përmban elemente për veprime kompetente të Komisionit Shtetëror në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Arkivi
Parashtruesi

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar
Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

